1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë

operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

13. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

14. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen

kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

15. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

16. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rast]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
-------------------	--

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti i kontratës: “**Kryerje e Shërbimit të Gjellbërimit në SUT, për një periudhë 36 muajore**”:

Sherbimi i mirëmbajtjes ditore të sipërfaqeve të gjelbërta të territorit të SUT do të bëhet në këto ambiente të ndara sipas këtyre zonave:

Zona 1

- Hyrja kryesore e SUT-së
- Ambientet rreth godinës 3-katëshe të **Shërbimit të Konsultave të Specializuara Ambulatorë**

Zona 2

- Përpara **Klinikës së Ortopedisë 1**
- Rruga drejt **Shërbimit të Pranimi të Urgjencës**
- Krahun anësor i **Shërbimit të Pranimi të Urgjencës**

Zona 3

- Ambientet rreth godinës së **Poliklinikës**
- Rreth godinës së **Sektorit të Statistikës dhe Informacionit Mjekësor**

Zona 4

- Pjesa e pasme e SUT-së
- Ambienti pranë **Depozitës së ujit**
- Përpara **Shërbimit të Fizioterapisë**
- Përpara ndërtesës së **Administratës**

Zona 5

- Përpara **Drejtorisë së SUT**
- Ambientet rreth **Shërbimit të Kirurgjisë së Këmbës Diabetike dhe Angiokirurgjisë**
- Zona me **ullinj**

Shërbimi i gjellbërimit të sipërfaqeve të gjelbërta të territorit të SUT do të kryhet sipas sasive të parashikuara në tabelën e punimeve si më poshtë:

Tabela Nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia 12 muaj	Frekuenca per 36 muaj	Sasia 36 muaj
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	m2	9,000	1095	27,000

2	Kositje bari dhe largimi i tyre	m2	9,000	36	27,000
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta	m2	9,000	369	27,000
4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)	m2	1,000	12	3,000
5	Mirëmbajtje pemesh dhe shkurresh	copë	900	36	2,700
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre	ml	180	15	540
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale	m2	100	6	300
8	Furnizim vendosje stolash të rinj	copë	10	3	30
9	Mirëmbajtje stolash në ambjentet e jashtme	copë	20	3	60
10	Furnizim vendosje kosha duhani	copë	5	3	15

*** Frekuenca për 36 muaj është e detajuar në Grafikon e zërave për tre vitet.**

- Shënim: Këto sasi janë parashikime sipas nevojave të SUT. Këto sasi mund të ndryshojnë sipas viteve në varësi të ndryshimeve në ambjentet e jashtme sipas rikonstruksionit që do të bëhet në 24 muajt në vazhdim. Këto ndryshime do të pasqyrohen në kërkesat e SUT dhe në kontratat që do të nënshkruhen mes palëve në tre vitet e Marrëveshjes Kuadër.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR SHËRBIMIN E GJELBËRIMIT

- 1. Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre** - Pastrimi me krehër bari është një proces që duhet të kryhet çdo ditë, për disa arsye të rëndësishme që lidhen si me mirëmbajtjen e mjedisit spitalor, ashtu edhe me shëndetin e sipërfaqeve të gjelbra.

Ky shërbim është thelbësor për shkak të:

- Fluksit të lartë të vizitorëve dhe pacientëve në SUT, i cili sjell domosdoshmërinë për mbajtjen në gjendje të pastër dhe të rregullt të ambienteve të jashtme; Funksionit ekologjik të pastrimit me krehër bari, i cili ndihmon në ajrosjen e barit, lejon qarkullimin e ajrit në rrënjë dhe përmirëson cilësinë e tokës; Rigjenerimit natyral të bimësisë, duke mbajtur të shëndetshme dhe të qëndrueshme në kohë sipërfaqet e gjelbërta; Përmirësimin të estetikës së territorit të SUT, duke krijuar një ambient më të pastër, të rregullt dhe të këndshëm për pacientët, vizitorët dhe stafin mjekësor.

Si përfundim, mirëmbajtja e përditshme përmes këtij procesi garanton që sipërfaqet e gjelbëruara të jenë të shëndetshme, të mirëmbajtura dhe vizualisht tërheqëse në çdo kohë.

- Në funksion të rritjes së ndërgjegjësimin të studentëve, stafit dhe vizitorëve për ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e hapësirave të gjelbërta brenda territorit të SUT, OE do të vendosi tabelat ndërgjegjëse informuese në zona të gjelbërta. **Specifikimet teknike të tabelave:** Përmasat: 60 cm (gjatësia) x 40 cm (gjerësia); Lartësia nga sipërfaqja e

tokës: 100 cm; Struktura mbajtëse: Dy këmbë metalike të qëndrueshme; Përmbajtja e tabelës: Mesazhe ndërgjegjësuere për ruajtjen e gjelbërimit, ndalimin e ndotjes dhe mbetjet urbane, si dhe thirrje për kujdes ndaj natyrës. Tabelat do të vendosen sipas kwrkesave të Ak dhe me kostot e OE të kontraktuar i cili duhet ta parashikojë këtë kosto në shërbimin e ofruar sipas zërave në tabelën nr. 1.

2. **Kositje bari dhe largimi i tyre** - Kositja e barit është një proces i domosdoshëm që kryhet periodikisht për të mbajtur lartësinë e barit në nivele të kontrolluara dhe për të parandaluar përhapjen e bimësisë së dëmshme ose të egër.

Ky shërbim përfshin:

- Prerjen e barit me kosë manuale ose mekanike, në përputhje me natyrën dhe terrenin e sipërfaqeve të gjelbërta; Grumbullimin e barit të prerë; Largimin e mbetjeve të barit nga ambientet e gjelbërta dhe transportimin jashtë territorit të SUT-së në pika të autorizuar për hedhjen e mbetjeve organike.
3. **Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta** - Vaditja me autobot është një proces i planifikuar për të siguruar furnizimin e vazhdueshëm me ujë për sipërfaqet e gjelbërta të SUT, veçanërisht në periudhat me mungesë reshjesh dhe temperatura të larta.

Frekuenca dhe sezonaliteti i shërbimit:

- Periudha Maj – Tetor
Gjatë kësaj periudhe, për shkak të temperaturave të larta dhe avullimit të shpejtë të ujit, vaditja kryhet sipas grafikut të shërbimit të parashikuar (dhe në raste të vecanta dhe të justifikuara me kërkesë të AK). Ky shërbim është i domosdoshëm për të garantuar gjallërinë, qëndrueshmërinë dhe rigjenerimin e bimësisë në të gjitha zonat e gjelbërta të territorit të SUT.
- Periudha Nëntor – Prill
Gjatë muajve të ftohtë, referuar përvojës së mëparshme, është vlerësuar se vaditja nuk është e nevojshme, për shkak të lagështirës natyrore dhe reshjeve atmosferike që mbulojnë nevojat ujore të bimësisë. Në raste të vecanta, vaditja mund të kryhet vetëm nëse kërkohet nga gjendja specifike e terrenit ose bimëve.

4. **Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m²)**- Ky shërbim përfshin furnizimin dhe mbjelljen e farës së barit në sipërfaqet e gjelbërta që kanë nevojë për rigjenerim, mbulim të zonave të dëmtuara ose krijimin e zonave të reja me bar natyral.

Specifikimet teknike:

- Lloji i farës: farë bari për qëllime dekorative dhe rezistente ndaj kushteve klimatike lokale;
- Doza e mbjelljes: 50 gram për metër katror (50 g/m²), në përputhje me rekomandimet teknike për mbulim optimal;

5. **Mirembajtje pemesh dhe shkurresh** - Mirëmbajtja e pemëve dhe shkurreve të mbjella në territorin e SUT përfshin një sërë veprimesh teknike që sigurojnë shëndetin, jetëgjatësinë dhe paraqitjen estetike të bimësisë.

Përbërësit e shërbimit:

- Punim me bel dhe shkriftim i tokës rreth bazës së pemës, për të përmirësuar ajrosjen dhe thithjen e lëndëve ushqyese nga rrënjët;
- Plehërimi i tokës me plehra organikë ose kimikë, sipas nevojës dhe karakteristikave të pemës dhe shkurres bazuar në ligjin Nr 17 dt 17.02.2020.
- Krasitja dhe dhënia e formave dekorative, duke respektuar nevojat e pemëve dhe shkurreve (të reja dhe të vjetra);
- Spërkatja me insekticide për mbrojtje nga dëmtuesit sezonalë dhe sëmundjet e zakonshme;
- Prerja e drurëve të vjetër ose atyre që paraqesin rrezik për sigurinë e njerëzve, infrastrukturës apo mjedisit përreth, do të kryhet vetëm në raste të justifikuara (kur ekziston një argumentim i qartë dhe i shkruar) dhe me dokumentacion përkatës (raport teknik ose akt-konstatim).
- Lyerja me gëlqere e trungut të pemëve në lartësi 50–100 cm për të: Mbrojtur kundër insekteve, parazitëve dhe rrezeve të forta të diellit dhe parandaluar çarjet në lëvore dhe infektimet në periudhat me ndryshime ekstreme të temperaturës
- Në kuadër të mirëmbajtjes dhe përmirësimit të hapësirave të gjelbërta në ambientet e SUT, do të realizohet nga OE zëvendësimi i pemëve dhe shkurreve që janë: Të thara plotësisht, të thara pjesërisht, të dëmtuara rëndë ose të vjetruara që kanë humbur funksionin estetik apo biologjik. Asnjë pemë apo shkurre nuk do të zëvendësohet pa miratimin paraprak të grupit të punës të ngritur nga SUT.

Kalendar i thjeshtuar vjetor:

Muaji	Pemët	Shkurret
Janar–Shkurt	Krasitje sanitare	—
Mars–Prill	Krasitje formuese, plehërim	Krasitje, plehërim
Maj–Qershor	Kontroll, ujitje	Formësim, ujitje
Korrik–Gusht	Monitorim, krasitje lehtë	Krasitje lehtë
Shtator	—	Plehërim, pastrim
Tetor–Nëntor	Krasitje dimërore	Krasitje sanitare
Dhjetor	Lyerje trungu (nëse duhet)	—

- 6. Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre** - Ligustra është një nga shkurret më të përdorura për krijimin e gardheve dekorative dhe bordurave të gjelbërta në ambientet publike. Për të ruajtur gjendjen e mirë të tyre, kërkohet një mirëmbajtje e rregullt dhe estetike e gardheve të gjelbërta që kufizojnë, ndajnë apo zbukurojnë hapësirat në territorin e SUT-së;

Përbërësit e shërbimit:

- Krasitja periodike e bordurave, për të ruajtur formën e qëndrueshme dhe simetrike të gardhit;
- Punim me bel dhe shkriftim i tokës në bazën e shkurres, për ajrosje të rrënjëve dhe thithje më të mirë të lëndëve ushqyese;
- Plehërim, në formë granulash ose të tretur:

Kalendari vjetor për krasitje te gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre:

Muaji	Veprim
Mars–Prill	Krasitje formuese pas dimrit
Maj–Qershor	Krasitje e dytë për kontroll të rritjes
Korrik	Krasitje lehtë për ruajtje forme
Shtator	Krasitje për përgatitje për vjeshtë
Tetor–Nëntor	Krasitje përfundimtare para dimrit

7. **Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale** - Ky shërbim përfshin furnizimin, mbjelljen dhe mirëmbajtjen e luleve dekorative sezonale në ambientet e jashtme të SUT, me qëllim ruajtjen e estetikës dhe pasurimin e hapësirave të gjelbërta.

Përshkrimi i shërbimit:

Mbjellje e luleve sezonale dy herë në vit (në fillim të pranverës dhe në fillim të vjeshtës), në përputhje me kalendarin natyror dhe klimatik.

Llojet e luleve duhet të jenë të **rezistueshme ndaj kushteve të jashtme**, të përshtatshme për klimën lokale dhe të kenë karakter dekorativ.

Sipërfaqet e mbjella do të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim ruajtjen e pamjes dekorative gjatë gjithë sezonit.

8. **Furnizim vendosje stolash te rinj-** Ky shërbim ka për qëllim **përmirësimin e infrastrukturës së ulëseve publike** në zonat e gjelbërta të Spitalit Universitar të Traumës (SUT), në përputhje me kërkesat estetike, funksionale dhe ergonomike të institucionit.

Specifikimet teknike të stolave:

Materiali: Stola prej **druri me skelet metalik** të galvanizuar ose të lyer me bojë antikorrozive për qëndrueshmëri në ambiente të jashtme me keto te dhena **Mbështetësja e shpinës:** 50 cm (lartësi) × 160 cm (gjatësi); **Pjesa ulëse:** 50 cm (thellësi) × 160 cm (gjatësi); **Lartësia totale nga toka:** 50 cm; **Dizajni dhe përmasat janë standardizuar**, me qëllim që stolat e rinj të jenë në përputhje dhe uniforme me ata ekzistues në SUT, duke ruajtur identitetin estetik të hapësirave të jashtme.

9. **Mirëmbajtje stolash ne ambientet e jashtme** - Do të kryhet një **mirëmbajtje periodike dhe ndërhyrje sipas nevojës** për të siguruar që stolat të jenë gjithmonë në gjendje funksionale dhe estetike të përshtatshme për përdorim publik.

Përbërësit e mirëmbajtjes:

- **Kontroll i rregullt vizual dhe teknik** i stolave për të identifikuar shenja të amortizimit, dëmtimeve fizike ose degradimit të materialeve;
- **Riparim i pjesëve të dëmtuara**, duke përfshirë: Rilidhje të elementëve të liruar; Zëvendësim të dërrasave të thyera ose të kalbura; Rilyerje e skeletit metalik për të parandaluar korrozionin; Rilyerje ose trajtim me vaj mbrojtës për pjesët druri;
- **Zëvendësim i pjesshëm ose total** i stolave, në rastet kur dëmtimi është i pakthyeshëm ose përbën rrezik për përdoruesit;

- **Pastrimi i sipërfaqeve** të stolave gjatë mirëmbajtjes periodike, për të ruajtur higjienën dhe pamjen e jashtme.

10. Furnizim vendosje kosha duhani - Ky shërbim përfshin **furnizimin dhe instalimin e koshave të posaçme për hedhjen e mbetjeve të duhanit**, në zonat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor (AK), me qëllim ruajtjen e pastërtisë dhe standardeve të higjienës në ambientet publike të SUT.

Specifikimet teknike të koshave:

Materiali metalik (material rezistent ndaj kushteve atmosferike dhe temperaturës së lartë); Koshë funksionale për mbetje duhani, të mbyllur dhe të pajisur me grykë të përshtatshme për fikjen e cigareve;

Permasat: **Lartësia**-jo më pak se 60 cm; **Diametri**: 20–25 cm;

Dizajni: i thjeshtë dhe i sigurt për përdoruesit, me pamje që harmonizohet me mjedisin urban dhe spitalor.

- Shërbimi i gjelbërimit në SUT do të kryhet gjatë gjithë vitit (365 ditë). Shërbimi do të realizohet cdo ditë në orarin 07.30°-16°.
- OE është i detyruar të zbatojë me përgjegjshmëri të gjitha punimet sipas tabelës nr 1. Per punimet e kryera do të perpilohet akt rakordimi deri në datën 10 të muajit pasardhës.
- Heqja e mbeturinave të procesit të gjelbërimit do të realizohet nga OE cdo ditë ose sa herë të jetë e nevojshme. Në asnjë rast këto mbeturina nuk do të digjen.

Detyrat e kontraktuesit

- OE duhet të vendosë një person permanent si pikë kontakti për ndjekjen e shërbimit në SUT.
- Uniforma e personelit do të jetë sipas kërkesave të SUT-së me logon e kompanisë (kostum pune veror dhe dimeror për kopshtari).
- Personeli të jetë bashkëpunues, për çdo të papritur dhe të përgjigjen kërkesave të SUT-së.
- OE duhet të ketë personel të kualifikuar sipas natyrës së shërbimeve që do të kryhen në SUT
- OE është i detyruar të sigurojë me shpenzimet e veta pajisjet, makineritë dhe veglat e punës që nevojiten për përmbushjen e kontratës. Këto pajisje, makineri dhe vegla duhet që sipërmarrësi t'i sigurojë që me fillimin e punës dhe me mbarimin e kontratës t'i tërheqë ato. Në SUT duhet të mos mungojë asnjë mjet i domosdoshëm për cdo ditë pune gjatë realizimit të kontratës.
- Në rast se OE e ka të nevojshme të marrë me qera ambiente të SUT-së për magazinimin e materialeve, lidhja e kontratës së qerasë do të bëhet sipas VKM Nr. 54 datë 5.2.2014. Me mbarimin e kontratës, OE i dorëzon ambientet në gjendje të rregullt dhe të gjitha riparimet që do të kryejë në to do të ngelen pjesë e SUT. Shpenzimet që bën për riparimin, mirëmbajtjen dhe rikonstruksionet e nevojshme përballohen nga vetë OE. Për instalime të reja teknologjike që mund të bëhen nga OE, me perfundimin e kontratës ato i mbeten SUT-së.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim i mirëmbajtjes të sipërfaqeve të gjelbra për SUT, për 36 muaj”.

Tabela Nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Njesia	Sasia 12 muaj	Frekuenca per 36 muaj	Sasia 36 muaj
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	m2	9,000	1095	27,000
2	Kositje bari dhe largimi i tyre	m2	9,000	36	27,000
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta	m2	9,000	369	27,000
4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)	m2	1,000	12	3,000
5	Mirembajtje pemesh dhe shkurresh	copë	900	36	2,700
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre	ml	180	15	540
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale	m2	100	6	300
8	Furnizim vendosje stolash te rinj	copë	10	3	30
9	Mirëmbajtje stolash ne ambjentet e jashtme	copë	20	3	60
10	Furnizim vendosje kosha duhani	copë	5	3	15

Grafiku i zërave për vitin e parë të kontratës

N r.	Përshkrimi	Jan ar	Shk urt	Ma rs	Pr ill	M aj	Qers hor	Kor rik	Gu sht	Shta tor	Tet or	Nën tor	Dhje tor	Tota li
1	Pastrim me krehër bari i mjedise	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365

	ve të gjelbërt a dhe largimi i tyre													
2	Kositje bari dhe largimi i tyre	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërt a					8	30	31	31	15	8			123
4	Furnizi m dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)			1	1					1	1			4
5	Mirembajtje pemesh dhe shkurre sh	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			1		1		1		1	1			5
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale			1						1				2
8	Furnizi m vendosje stolash te rinj	Sipas kërkesave të AK												10

9	Mirëmbajtje stolash në ambjentet e jashtme	Sipas kërkesave të AK	20
10	Furnizimi vendosje kosha duhani	Sipas kërkesave të AK	5

Grafiku i zërave për vitin e dytë të kontratës

Nr.	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Kositje bari dhe largimi i tyre	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta					8	30	31	31	15	8			123
4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)			1	1					1	1			4
5	Mirëmbajtje pemesh dhe shkurresh	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			1		1		1		1	1			5
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale			1						1				2

8	Furnizim vendosje stolash te rinj	Sipas kërkesave të AK	10
9	Mirëmbajtje stolash ne ambjentet e jashtme	Sipas kërkesave të AK	20
10	Furnizim vendosje kosha duhani	Sipas kërkesave të AK	5

Grafiku i zërave për vitin e tretë të kontratës

N r.	Përshkrimi	Jana r	Shkurt	Mars	Pril l	Maj	Qersho r	Korri k	Gusht	Shtato r	Tetor	Nënto r	Dhj etor	Tota li
1	Pastrim me krehër bari i mjediseve të gjelbërta dhe largimi i tyre	31	28	31	30	31	30	31	31	30	31	30	31	365
2	Kositje bari dhe largimi i tyre	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
3	Vaditje e sipërfaqeve të gjelbërta					8	30	31	31	15	8			123
4	Furnizim dhe mbjellje farë bari (50 g /m2)			1	1					1	1			4
5	Mirembajtje pemesh dhe shkurresh	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
6	Krasitje e gardheve të gjelbra dhe largimi i tyre			1		1		1		1	1			5
7	Mbjellja dhe mirëmbajtja e luleve dekorative sezonale			1						1				2

8	Furnizim vendosje stolash te rinj	Sipas kërkesave të AK	10
9	Mirëmbajtje stolash ne ambjentet e jashtme	Sipas kërkesave të AK	20
10	Furnizim vendosje kosha duhani	Sipas kërkesave të AK	5

** Frekuenca për 36 muaj është e detajuar në Grafikon e zërave për tre vitet.*

Afatet e ekzekutimit:

Afati i ekzekutimit të shërbimit është: 36 muaj.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Kryerje e shërbimit të Gjellbërimit në SUT” për një periudhë 36 mujore**”.

Detyrat: Sipas Specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas Specifikimeve teknike

Vendi i dorëzimit të shërbimeve: SUT

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-
- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për “Prodhim dhe tregtim të produkteve të mbrojtjes së bimëve” Kodi II.5.A.

2.3.4 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të mirembajtjes objekt prokurimi për të gjitha zonat e territorit të SUT, duhet të kenë të punësuar minimumi 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës, si më poshtë:

- 1 (një) Përgjegjës shërbimi
- 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës shërbimi/ kopshtar
- 2 punonjës shofer

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

a. Për Përgjegjësin e Shërbimit:

Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë Inxhinier Mjedisi / Inxhinier pyjesh/ agronom, dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë me profesion Inxhinier Mjedisi / Inxhinier pyjesh/ agronom.
- Kontratë pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

b. Për punonjësit e shërbimit /kopshtar

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- 5 (pesë) prej tyre duhet të jenë të trajnuar dhe të pajisur me çertifikate për punonjës gjelbërimi të lëshuara nga shoqëri të licensuara (të vlefshme).

c. Për punonjësit shofer

- Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme)
- Leje drejtimi (e vlefshme).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.
Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Nr	Mjetet	Sasia	Njesia
	Mjet per vaditjen e sipërfaqeve të gjelberta (Autobot)	1	copë
	Mjet teknologjik për largimin e mbetjeve	1	copë
	Kamioncine vetshkarkuese me kapacitet mbajtës minimalisht 1.5 ton	1	copë
	Gërshërë	5	copë
	Pompa të montueshme në pick-up	1	copë
	Motorrsek për krasitje në lartësi	1	copë
	Pompa shpine	5	copë
	Shkallë për ngjitje në lartësi	1	copë
	Pajisje të sigurisë në punë (jelekë, kaska/kapele, syze etj)	10	copë

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet, si më poshtë:

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqese dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

